

Ekzekutimi i Vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që Lidhen me Procedimet Penale: Vështrim Krahasues mbi Rihapjen e Procesit Penal në Nivel Kombëtar.

Valbona Pajo (Bala)*

Abstrakt

Qëllimi i punimit është paraqitja e arritjeve dhe sfidave të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës gjatë procesit të ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), proces i cili është konceptuar si mekanizëm për rritjen e besueshmërisë, të efektivitetit të sistemit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe si faktor përcaktues për uljen e ngarkesës së GJEDNJ-së. Përmes analizës së detyrimeve që burojnë nga Konventa për Palët Kontraktuese dhe krahasimit të sistemeve ligjore mbi mundësinë ligjore të rihapjes së procedimeve penale, punimi paraqet pasojat e ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së në rrafshin individual, duke u fokusuar në mundësitë për përmirësimin e pozitës juridike të individit që ka një vendim të GJEDNJ-së në favor, kompensimin real të dëmit që ka pësuar nga shkelja dhe, në rrafshin më të përgjithshëm dhe abstrakt, atë shtetëror diskutimi përqëndrohet mbi gadishmërinë e Shtetit për riparimin e situatës të shkaktuar nga shkelja, por edhe pengesat e hasura.

Fjalët kyç: GJEDNJ; Vendim; Fuqi detyruese; Sistem ligjor; Reformë.

1. Hyrje

Ekzekutimi efektiv i vendimeve të formës së prerë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) përbën një nga angazhimet kryesore të Palëve të Larta Kontraktuese, të cilat përmes ratifikimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe protokolleve shtesë të saj, kanë marrë përsipër të

* (MA, Doktorante). Këshilltare e Gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Qendrimet e shprehura në këtë punim janë personale. (Autorja mund të kontaktohet në: valbonapajo@gmail.com).

respektojnë vendimet e GJEDNJ-së në çdo çështje ku ato janë palë. Ky angazhim buron nga neni 46 i KEDNJ-së, i cili parashikon fuqinë detyruese të vendimeve, procedurat për ekzekutimin e tyre, duke përcaktuar Këshillin e Ministrave si organin përgjegjës për mbikqyrjen e këtij procesi.

Procesi i ekzekutimit të vendimit të formës së prerë mbetet një proces kompleks, i ndikuar nga situata sociale, ekonomike dhe politike e shteteve kontraktuese dhe, në këtë kuptim, parashikimi i Komitetit të Ministrave si mekanizmi mbikqyrës i këtij procesi i shërben eliminimit të pengesave dhe vështirësive ashtu dhe ekzekutimit sa më efektiv të vendimeve të formës së prerë.¹

Kërkesat e nenit 46 të KEDNJ-së, kanë gjetur zbatim gjerësisht në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila e ka konsideruar dështimin tërësor ose të pjesshëm të ekzekutimit të vendimit të GJEDNJ-së si burimin e përgjegjësisë ndërkombëtare të shtetit palë, i cili, në këtë rast, ka detyrimin jo vetëm të shlyejë dëmin material ndaj personave të interesuar, por edhe të marrë masa individuale dhe/ose, nëse është e përshtatshme, masa të përgjithshme në rendin e vet ligjor, që t'i japë fund shkeljes së gjetur nga gjykata dhe rregullimit të pasojave të shkeljes, me qëllimin që kërkuesi të rikthehet, për aq sa është e mundur, në gjendjen që ishte para se të bëhej shkelja.²

Ekzekutimi i vendimeve të GJEDNJ-së është i një rëndësie thelbësore jo vetëm për rritjen e besueshmërisë dhe të efektivitetit të sistemit të Konventës dhe si faktor përcaktues për uljen e ngarkesës së GJEDNJ-së,³ por edhe për pasojat që sjell në dy drejtime kryesore: *së pari*, në rrafshin individual dhe, *së dyti*, në atë më të përgjithshëm dhe abstrakt, në rrafshin shtetëror. Pasojat në rrafshin individual lidhen me masën e përmirësimit të pozitës juridike të individit, i cili ka tashmë një vendim të GJEDNJ-së në favor ashtu edhe me kompensimin real të dëmit që ka pësuar nga shkelja. Në çdo rast, individi synon *restitutio in integrum* përmes pagesës efektive të shpërblimit të drejtë (dhe interesit në rast vonese) të përcaktuar në vendim. Kurse në rastin kur pasojat e shkeljes nuk mund të kompensohen nga shpërblimi i drejtë, Komiteti i Ministrave siguron që autoritetet kombëtare të marrin masa të tjera individuale në favor të aplikantit, të cilat variojnë nga rihapja e procedurës gjyqësore deri në fshirjen e dënimit nga aktet e gjëndjes gjyqësore. Përsa i përket pasojave në rrafshin më të

¹ Në ushtrimin e funksionit mbikqyrës Komiteti i Ministrave mbështetet nga Departamenti për Ekzekutimin e Vendimeve, pjesë e Departamentit të Përgjithshëm për të Drejtat e Njeriut dhe Çështjet Ligjore. Procedura e mbikqyrjes bazohet në "planet e veprimit" dhe "raportet e veprimit" të paraqitura nga shteti përkatës.

² *Scozzari dhe Giunta kundër Italisë* [DHM], nr. 39221/98 dhe 41963/98, GJEDNJ 2000-VIII, para. 249; *Assanidze kundër Gjeorgjisë* [DHM], nr. 71503/01, GJEDNJ 2004-II, para. 198.

³ Komiteti i Ministrave ka riafirmuar këtë qëndrim në sesionin e 120-të mbajtur në Maj 2010, në vazhdim të Konferencës së Nivelit të Lartë të Interlaken (shkurt 2010). I disponueshëm në:

<<http://hub.coe.int/event-files/sessions-committee-of-ministers/session-11-may-2010>> (hera e fundit e aksesuar: 10 Dhjetor 2013).

përgjithshëm, ato kanë të bëjnë me gadishmërinë e shtetit për riparimin e situatës të shkaktuar nga shkelja e ndonjë prej të drejtave dhe lirive të parashikuara nga KEDNJ-ja, shkelje këto të konstatuara përmes vendimit të GJEDNJ-së si dhe me natyrën e masave që duhet të ndërmarrë shteti për parandalimin e shkeljeve të ngjashme në të ardhmen, me qëllim garantimin e të drejtave dhe lirive themelore. Masat e përgjithshme që çmohen si të nevojshme përfshijnë ndryshime kushtetuese ose ligjore, ndryshime në jurisprudencën kombëtare, si dhe masa praktike si rekrutimi i gjyqtarëve ose rinovimi i mjediseve të vjetëruara të burgjeve.⁴

Me miratimin e Protokollit nr.14 të KEDNJ-së, procesi i ekzekutimit është pasuruar me rregulla të reja, të cilat synojnë, midis të tjerash, prioritizim më të mirë të çështjeve, rritjen e transparencës dhe bashkëpunimin midis palëve.⁵

2. Diskrecioni i shteteve në përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga neni 46 i KEDNJ-së

Procesi i ekzekutimit merr rëndësi edhe për vetë vlerën që vendimet e GJEDNJ-së kanë në dy aspekte, që lidhen me: (i) natyrën detyruese dhe (ii) mënyrën e zbatimit të tyre në sistemin e brendshëm. Fuqia detyruese e këtyre vendimeve përcaktohet drejtpërdrejt nga KEDNJ-ja,⁶ kurse përsa i përket mënyrës së zbatimit të tyre GJEDNJ-ja pranon se, nën vëzhgimin e Komitetit të Ministrave, shteti i paditur në parim mund t'i zgjedhë vetë mjetet për të përmbushur detyrimet sipas nenit 46/1 të KEDNJ-së, me kusht që mjetet të jenë në përputhje me konkluzionet e vendimit të GJEDNJ-së.⁷ Megjithatë, në disa raste të veçanta

⁴ Për më tepër shih:

<http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/execution/Presentation/About_en.asp> (hera e fundit e aksesuar: 10 Dhjetor 2013).

⁵ Komiteti i Ministrave, ka të drejtë që në rast se konstaton se mbikqyrja e ekzekutimit pengohet nga një problem i interpretimit të vendimit të GJEDNJ-së, ai të mund t'ia referojë çështjen Gjykatës për t'u shprehur me vendim për çështjen e interpretimit. Nëse Komiteti i Ministrave është i mendimit se një Palë e Lartë Kontraktuese refuzon të respektojë një vendim të formës së prerë të Gjykatës në një çështje ku ajo është palë, pasi t'i ketë dërguar një njoftim formal asaj Palë dhe me vendim që merret me një shumicë prej dy të tretave të përfaqësuesve që marrin pjesë në të, mund t'i referojë problemin GJEDNJ-së. Nëse kjo e fundit konstaton shkelje të angazhimit për ekzekutimin e vendimit, ia referon çështjen Komitetit të Ministrave për shqyrtimin e masave që duhen marrë. Nëse nuk gjen asnjë shkelje, GJEDNJ-ja ia referon çështjen Komitetit të Ministrave, i cili e mbyll shqyrtimin e çështjes. Për më tepër shih raportin vjetor 2011 të Këshillit të Ministrave, prill 2012, në faqen 12: <http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/execution/Source/Publications/CM_annreport2011_en.pdf> (hera e fundit e aksesuar: 10 Dhjetor 2013).

⁶ GJEDNJ-ja në mënyrë të vazhdueshme ka theksuar parimet që rregullojnë zbatimin e vendimeve të saj, duke i vënë theksin zbatimit efektiv të këtyre vendimeve. Shih për më tepër vendimet në çështjet *Verein Gegen Tierfabriken SchWeiz (VgT) kundër Zvicrës* (nr.2), nr.32772/02, 30 qershor 2009, paras 46-50; *Bronioëski Wkundër Polonisë* [DHM], nr.31443/96, GJEDNJ 2004-V, para.192; *Pisano kundër Italisë* [DHM], nr.36732/97, 24.10.2002, para. 43; *Scozzari dhe Giunta kundër Italisë* (n 2), para. 249; dhe *Sejdovic kundër Italisë* [DHM], nr.56581/00, GJEDNJ 2006, para. 119.

⁷ *Scozzari dhe Giunta kundër Italisë*, (n 2), para. 249.

GJEDNJ-ja e ka gjetur të dobishme që t'i tregojë shtetit të paditur llojin e masave që mund të merren për t'i dhënë fund shkeljes.⁸ Në raste të tjera, natyra e shkeljes nuk lë asnjë rrugëdalje për masat që duhet të merren.⁹ Megjithatë, kur një individ është dënuar sipas procedurave të cilat kanë sjellë cenim të kërkesave të nenit 6 të KEDNJ-së, GJEDNJ-ja mund të rekomandojë që rigjykimi ose rihapja e çështjes, nëse kërkohet, përfaqëson në parim një mënyrë të përshtatshme për rregullimin e shkeljes.¹⁰ Ky qëndrim është në përputhje me udhëzimet e Komitetit të Ministrave, i cili i ka bërë thirrje shteteve palë të KEDNJ-së që të përfshijnë mekanizma në nivel vendor për rishqyrtimin ose rihapjen e çështjes, me kusht që kjo masë të përfaqësojë “mjetin më të efektshëm, në mos të vetmin për arritjen e *restitutio in integrum*”.¹¹

Rishikimi i sistemeve ligjore me qëllim përfshirjen e parashikimeve ligjore që rregullojnë rihapjen e procedurave në ato raste kur GJEDNJ-ja ka konstatuar shkelje të Konventës, sugjerohet veçanërisht në rastet:

- (i) kur pala e dëmtuar vazhdon të vuajë pasoja shumë negative për shkak të vendimit të dhënë nga instancat kombëtare, pasoja këto që nuk janë riparuar përmes shpërblimit të drejtë dhe nuk mund të rivendosen përveç se me rishqyrtimin ose rihapjen e procedurave;
- (ii) kur GJEDNJ-ja ka arritur në konkluzionin se: (a) vendimi kombëtar i kundërshtuar është, në themel, në kundërshtim me Konventën; ose (b) shkelja e konstatuar bazohet në gabime procedurale ose mangësi aq serioze sa ngre dyshime mbi rezultatin e procedimeve vendase të kundërshtuara.¹²

Veçanërisht në fushën e së drejtës penale, rishqyrtimi i një çështjeje, përfshirë dhe rihapja e procedimeve, është i një rëndësie thelbësore. Qëllimi i kriterëve shtesë të përpunuara nga Komiteti i Ministrave është ‘të identifikojë ato situata përjashtimore në të cilat sigurimi i të drejtave të individit dhe zbatimi efektiv i vendimeve të GJEDNJ-së dominojnë ndaj parimeve që qëndrojnë në themel të doktrinës së *res judicata*, veçanërisht lidhur me sigurinë juridike, pavarësisht rëndësisë së padiskutueshme të këtyre parimeve’.¹³ Ndonëse KEDNJ-ja nuk përmban ndonjë nen që të parashikojë detyrimin e Shteteve Kontraktuese për të

⁸ *Öcalan kundër Turqisë*, nr.46221/99, GJEDNJ 2005-IV, para. 210; *Popov kundër Rusisë*, nr.26853/04, 13 korrik 2006, para. 263.

⁹ *Assanidze kundër Gjeorgjisë*, nr.71503/01, 8 prill 2004, para. 202.

¹⁰ *Gençel kundër Turqisë*, nr.53431/99, 23 tetor 2003, para. 27; *Öcalan kundër Turqisë* (n 8), para. 210; *Claes dhe të tjerë kundër Belgjikës*, nr.46825/99, 47132/99, 47502/99, 49010/99, 49104/99, 49195/99 dhe 49716/99, 2 qershor 2005, para. 53.

¹¹ Rekomandimi Nr. R (2000) 2 i Komitetit të Ministrave për shteteve anëtare lidhur me rishqyrtimin ose rihapjen e disa çështjeve në nivel kombëtar në zbatim të vendimeve të GJEDNJ-së (Miratuar nga Komiteti i Ministrave në 19 Janar 2000 në takimin e 694).

¹² Po aty.

¹³ Po aty, pika 10 e raportit shpjegues. I disponueshëm në: <<https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=334147>> (hera e fundit e aksesuar: 10 Dhjetor 2013).

përfshirë në ligjin kombëtar rishqyrtimin ose rihapjen e proceseve gjyqësore, ekzistenca e këtyre mundësive ka rezultuar, në disa raste, e rëndësishme dhe e vetmja mënyrë për të siguruar *restitutio in integrum*¹⁴.

Një numër i konsiderueshëm shtetesh anëtare të Këshillit të Evropës parashikojnë në sistemet e tyre ligjore mundësinë për rihapjen e procedurave të përfunduara me një vendim me fuqinë e *res judicata*¹⁵. Rihapja e procedurave nënkupton rishikimin e vendimit duke marrë në konsideratë vendimin e GJEDNj-së si përsa i përket aspekteve materiale ashtu dhe atyre procedurale. Rihapja e procedurave shtron për zgjidhje disa çështje, si për shembull, në cilat fusha të së drejtës është e mundur rihapja e procedurave; si duhen trajtuar interesat e palëve të treta;¹⁶ në lidhje me cilat shkelje të KEDNj-së (procedurale apo materiale) duhet të parashikohet rihapja e procedurave; cili është subjekti që legjitimohet të kërkojë rihapjen;¹⁷ cili organ duhet të vendosë lidhur me pranueshmërinë ose jo të kërkesës për rihapje; çfarë qëndrimi duhet mbajtur lidhur me çështjet të cilat nuk janë dërguar përpara GJEDNj-së, etj.

Praktikat e shteteve anëtare të KE-së lidhur me mundësinë e rihapjes së procedurave dhe elementet përbërës nuk janë aspak uniform¹⁸. Shtetet anëtare të KE-së mund të ndahen në disa kategori në varësi të përfshirjes ose jo në sistemet tyre ligjore të mjetit procedural të rihapjes së procedimit pas dhënies së një vendimi të GJEDNj-së që konstaton shkeljen e Konventës. *Kategoria e parë*, përfshin shtete si Lihtenshtein që nuk parashikojnë asnjë mundësi ligjore për rihapjen e procedurave. *Kategoria e dytë* përfshin shumicën e shteteve anëtare të KE-së, të cilët në sistemet e tyre ligjore kanë përfshirë norma të cilat gjejnë zbatim në fushën e së drejtës penale. Norma të ngjashme në fushën e të drejtës civile dhe asaj administrative janë më të pakta, gjë që shpjegohet me faktin e përfshirjes së palëve të treta private, për të cilat siguria juridike duhet të garantohet. Shtete si Gjermania, Greqia, Luksemburgu, Austria, Holanda, Belgjika, Italia (e kufizuar), Bullgaria, Kroacia, Lituania, Polonia, Sllovenia janë shembuj për përfshirjen në sistemet e tyre ligjore të një norme të veçantë për rihapjen e procedimeve në fushën penale. Një situatë e ngjashme paraqitet në Bullgari, Lituani dhe Norvegji për rihapjen e procedimeve në fushën civile dhe atë administrative. Në ato vende që parashikojnë rihapjen e procedimeve, një gjë e

¹⁴ Po aty, pika 3.

¹⁵ Studim i Komitetit të Ekspertëve për përmirësimin e procedurës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut "Rihapja e procedimit përpara gjykatave kombëtare në vijim të konstatimit të shkeljeve nga GJEDNj-ja DH-PR (99)10 9 gusht 1999 dhe më i fundit, nga van Kempen (2003). I disponueshëm në:
<http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/cddh/Meeting%20reports%20committee/61stAddI_en.pdf> (hera e fundit e aksesuar: 10 Dhjetor 2013).

¹⁶ T. Barkhuysen, M. L van Emmerik, 'A Comparative View on the Execution of judgments of the European Court of Human Rights', 8, në T. Christou, J.P. Raymond (Red), *European Court of European Rights: Remedies and Execution of Judgments*, (BIICL 2003).

¹⁷ Ibid.

¹⁸ Ibid.

tillë bazohet në një normë ligjore e cila fokusohet veçanërisht në vendimet e GJEDNJ-së, ose në norma me karakter të përgjithshëm, që mbulojnë gjithashtu arsye të tjera për rihapjen e procedimeve, si psh. fakte të reja që janë vendimtare për rezultatin e çështjes. *Kategoria e tretë* përfshin ato shtete të KE-së që kanë në sistemet e tyre ligjore një normë të vetme, të zbatueshme në fushën e të drejtës penale, civile dhe administrative si Zvicra dhe Malta. *Kategoria e katërt* përfshin shtete si Portugalia, Armenia, Azerbajxhani, Bosnja, Gjeorgjia, San Marino, ku situata ligjore nuk është e qartë, pasi sistemet e tyre ligjore nuk parashikojnë rihapjen e procedimeve për shkak të një vendimi të GJEDNJ-së, por norma të përgjithshme për rihapjen, megjithatë nuk është e qartë nëse këto norma mund të shërbejnë si bazë për të reaguar ndaj konstatimeve të GJEDNJ-së.¹⁹

3. Vështrim Krahasues mbi Rihapjen e Procedimeve Penale nën Dritën e Jurisprudencës Kushtetuese

Në kushtet e mungesës së mjetit procedural të përshtatshëm dhe efektiv në sistemet ligjore kombëtare, ose iniciativave të munguara ligjvënëse, çështja e rihapjes së procesit është gjithmonë e më tepër në fokusin e vendimeve të GJEDNJ-së, të cilat luajnë rolin e katalizatorit si përsa i përket ndryshimeve në sistemet ligjore, por dhe për zhvillimin e jurisprudencës kushtetuese në përputhje me praktikën më të mira. Megjithatë, duhet të pranojmë se kufijtë e efektit nxitës janë të përcaktuar, pasi GJEDNJ-ja nuk ka kompetencën për të shfuqizuar legjislacionin kombëtar ose vendimet të cilat janë në kundërshtim me KEDNJ-në. Gjithashtu, nuk ka as pushtetin për të rishikuar vendimet përfundimtare të gjykatave kombëtare; nuk e konsideron veten në pozitë që mund të japë urdhra për Shtetet palë të Konventës; dhe as mund të japë rekomandime se cilat janë hapat konkrete që ato duhet të ndjekin për rregullimin e pasojave që burojnë nga shkelja e Konventës.²⁰

Në vitin 2011, Gjykata Kushtetuese Italiane, e vënë në lëvizje përmes një kërkesë për kontroll incidental, u shpreh se, bazuar në nenin 46, paragrafi 1 i KEDNJ-së, me qëllim zbatimin e një vendimi përfundimtar të GJEDNJ-së, neni 630 i Kodit të Procedurës Penale është në kundërshtim me Kushtetutën për shkak se nuk 'parashikon shkaqe të tjera për rishikimin e një vendimi apo dënimi me qëllim rihapjen e procedimeve kur kjo është e nevojshme, për t'u konformuar me një vendim të GJEDNJ-së të formës së prerë'.²¹ Vendimi paraqet rëndësi pasi trajton hollësisht dallimet që ekzistojnë midis mjetit të jashtëzakonshëm të rishikimit dhe procedurës së rihapjes së procesit, duke argumentuar se:

¹⁹ Ibid, 6, 9, 11.

²⁰ Assanidze kundër Gjeorgjisë (n 9).

²¹ Gjykata Kushtetuese Italiane, Vendimi nr.113/2011, datë 04 Prill 2011, i disponueshëm në <<http://www.cortecostituzionale.it/actionSchedaPronuncia.do?anno=2011&numero=113>> (hera e fundit e aksesuar: 10 Dhjetor 2013).

Për rihapjen e procesit nuk mund të përdoret mjete i jashtëzakonshëm i ankimit, rishikimi, element historik i procedurës penale. Kjo për faktin se situata në fjalë, pra rihapja e procesit, nuk mund të klasifikohet në asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 630 i KPP-së. Për më tepër, kjo tërësi rastesh reflekton klasifikimin tradicional të këtij instituti si një instrument që synon të zgjidhë papajtueshmëritë midis “të vërtetës brenda procesit” që zhvillohet nga gjykata dhe “të vërtetës historike” që rezulton nga elementët faktikë “të jashtëm” të procesit gjyqësor. Me fjalë të tjera, kjo çon në zgjidhjen e vlerësimit të gabuar që gjykata i ka bërë rrethanave të çështjes, gabim i cili mund të rezultojë nga një krahasim me faktet e marra parasysh në vendime të tjera të ndryshme nga ai i kundërshtuar, ose mund të rezultojnë nga njohuri të pamjaftueshme mbi provat në kohën e marrjes së vendimit, ose si rezultat i sjelljes kriminale”.²²

Në arsyetimin e saj Gjykata Italiane vijon duke theksuar se:

Situata është krejtësisht e ndryshme në rastet kur GJEDNJ-ja ka konstatuar shkelje të nenit 6 të Konventës. Në të tilla raste është e nevojshme të riparosh një gabim të ndodhur gjatë procesit, por përtej kufijve të vendimit përfundimtar (tradicionalisht e konsideruar si pika ndarëse për kundërshtime që lidhen me erroreset in procedendo), duke rihapur procesin dhe duke e vendosur palën e interesuar në situatën në të cilën ai/ajo nuk do të ndodhej nëse nuk do të kishte ndodhur shkelja. Në anën tjetër, zgjidhja e mungesës së “rregullsisë” jo domosdoshmërisht nënkupton lirimin e të dënuarit: çdokush, i cili është dënuar nga një gjykatë, që në opinionin e GJEDNJ-së ka qenë e njëanshme ose e varur, ka të drejtën e rihapjes së procesit përpara një gjykate, që plotëson kërkesat e nenit 6 (1) të Konventës. Procesi i ri mund të përmbyllet me një vendim dënimi, sesa me lirim, duke marrë në konsideratë në çdo rast ndalimin e reformatio in peius.²³

Rihapja e procesit konsiderohet si një zgjidhje heterogjene krahasuar me format e tjera të rishikimit që parashikojnë këto legjislacione, për faktin se tejkalon logjikën mbi të cilën bazohen zgjidhjet për të kaluar hendekun midis “të vërtetës në proces” dhe “të vërtetës historike” që rezulton nga elementet faktikë të jashtëm të procesit tashmë të përfunduar. Kjo formë “rishikimi” çon në një përjashtim, që lind për shkak të kërkesës për të respektuar detyrimet që burojnë nga e drejta ndërkombëtare. Në këtë kontekst, ‘gjykata rishikuese duhet të vlerësojë sesi shkaqet e parregullsisë së procesit të mëparshëm të konstatuar nga GJEDNJ-ja përkthehen në gabime të veprimeve procedurale të parashikuara nga legjislacioni kombëtar dhe, për rrjedhojë, duhet të marrë të gjitha masat e duhura që këto gabime apo parregullsi të mos ndodhin në procesin e ri

²² Ibid, paragrafi 5.

²³ Po aty.

gjyqësor'.²⁴

Rasti i Italisë nuk është i vetmi në këtë drejtim. Një pjesë e vendeve anëtare të Këshillit të Evropës, përmes zhvillimeve jurisprudenciale në përputhje me praktikat më të mira, gjithmonë e më tepër po i japin jetë parimit se shtetet që aderojnë në KEDNJ janë të detyruar të respektojnë vendimet e GJEDNJ-së, pa pritur të jenë ndëshkuar nga kjo Gjykatë më parë ose të kenë ndryshuar legjislacionin e tyre²⁵. Kështu, Gjykata Kushtetuese spanjolle, në lidhje me vendimin e GJEDNJ-së "*Barbera etj kundër Spanjës*", në mungesë të ligjit të shprehur, vendosi rishikimin e vendimit përfundimtar me efekt *res judicata* me argumentin se "lënia në fuqi e një vendimi me shkelje të rënda procedurale ishte në kundërshtim me rendin kushtetues". Në mënyrë të ngjashme, GJEDNJ-ja (në dy vendimet e saj të vitit 2004 "*Maestri kundër Italisë*" dhe "*Asanidze kundër Gjeorgjisë*") dhe Këshilli i Ministrave (në Rekomandimin e tij 6/2004 *Për përmirësimin e mjeteve të brendshme të ankimit*) përcaktuan se shtetet ishin të detyruara të modifikonin të drejtën e tyre të brendshme për t'u dhënë fund shkeljeve të Konventës dhe për të ekzekutuar vendimet e GJEDNJ. Modifikimi i së drejtës së brendshme nënkupton edhe krijimin e mjetit juridik nga gjykatat, në mungesë të ligjit të shprehur. Për të ilustruar këtë çështje, kohët e fundit, Asambleja Plenare e Gjykatës së Lartë Franceze pas vendimit të GJEDNJ-së në çështjen "*Brusco kundër Francës* ku mohimi i së drejtës për t'u patur kontakt me një avokat gjatë orëve të para të paraburgimit dhe kërkesa për të pandehurit për t'u betuar para dhënies së dëshmisë u konsideruan shkelje të nenit 6, vendosi t'i japë efekt të menjëhershëm vendimit lidhur me të drejtën për të patur kontakt të menjëherëm me një avokat, megjithëse legjislacioni përkatës, nuk ishte amenduar ende.²⁶

4. Rasti i Shqipërisë

Çështja e rihapjes së procesit penal pas dhënies së vendimit të GJEDNJ-së në favor të aplikantit ka qenë edhe në fokusin e jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë pas dhënies së vendimit të GJEDNJ-së në çështjen "*Xheraj kundër Shqipërisë*".²⁷ Paraprakisht vlen të theksohet se vendimi në fjalë i

²⁴ Po aty, paragrafi 9.

²⁵ Shih për më tepër K. Traja, T. Alexandridis, *Rreth Mundësisë së Rishikimit të Vendimeve Penale Përfundimtare pas Konstatimit nga GJEDNJ-ja të Shkeljeve të Procesit të Drejtë në Çështjen "Laska dhe Lika kundër Shqipërisë*, Amicus Curiae, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë Soros dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit, 4-5. I disponueshëm në <<http://www.soros.al/2010/article.php?id=325>> (hera e fundit e aksesuar: 10 Dhjetor 2013).

²⁶ Po aty, 4-5.

²⁷ GJEDNJ-ja konstatoi se kërkesa e prokurorit për të apeluar jashtë afatit ligjor vendimin e pafajësisë ndaj Arben Xheraj dhe pranimi i kësaj kërkesë, duke i dhënë të drejtë prokurorit për rivendosje në afat të ankimit, ka sjellë shkeljen nga Gjykata e Lartë të parimit të sigurisë juridike, sipas nenit 6/1 të KEDNJ. Kërkuesi, duke patur një vendim të GJEDNJ-së në favor, iu drejtua Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar pavlefshmërinë e vendimit nr.417, datë 20.06.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së të

hapi rrugën një diskutimi me vlera doktrinale dhe jurisprudenciale.

Sistemi ligjor procedural penal parashikon në nenin 450 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) *mjetin procedural të rishikimit*, duke përcaktuar se rishikimi mund të kërkohet kur:

- a) faktet e vëna në themel të vendimit nuk pajtohen me ato të një vendimi tjetër të formës së prerë;
- b) vendimi është bazuar në një vendim të gjykatës civile, i cili është revokuar më pas;
- c) kanë dalë ose janë zbuluar prova të reja, të cilat vetëm ose së bashku me ato që janë vlerësuar njëherë, tregojnë se vendimi është i gabuar;
- d) vërtetohet se vendimi është dhënë si pasojë e falsifikimit të akteve të gjyqimit ose të një fakti tjetër të parashikuar nga ligji si vepër penale.

Hipotezat e nenit 450 të KPP-së nuk parashikojnë shprehimisht mundësinë e rihapjes së procesit, ashtu siç e parashikon neni 494, pika “ë” e Kodit të Procedurës Civile (KPC) ose neni 42, pika “ç” i ligjit nr.10193, datë 03.12.2009 “Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale” për efekte të ekstradimit, por, gjithashtu, duhet të theksohet se as nuk e përjashton shprehimisht.²⁸ Meqenëse gjyqtari nuk mund të refuzojë të japë drejtësi me pretekstin se mungon ligji ose dispozita përkatëse, atëherë ai është i detyruar ta kapërcejë ose ta mbushë vakumin ligjor me anë të zbatimit të analogjisë (parimi i zbatimit subsidiar të ligjit). Në rastin konkret, sfera ku ajo aplikohet është procesi gjyqësor, i cili nga natyra e vet si në fushën civile ashtu dhe penale paraqet karakteristika të ngjashme: aspekti i mbrojtjes së të drejtave individuale është evident, çështja kërkon rregullim juridik dhe ky rregullim është i parashikuar në nenin 494/ë të KPC. Analogjia është e plotë sepse bëhet fjalë për të njëjtin institut procedural – rishikimin e vendimeve gjyqësore përfundimtare. Zbatimi i nenit 494/ë të KPC me analogji synon zgjerimin e të drejtave të individëve në procesin penal dhe nuk mund të konsiderohet si rrezik për rendin publik dhe drejtësinë. Përkundrazi, nevojat e drejtësisë kërkojnë që shkeljet e vërtetuara nga GJEDNJ të riparohen dhe që asnjë vendim të mos veprojë në kundërshtim me rendin kushtetues. Parimi i *res judicata* nuk është absolut në kuptimin se ai nuk mund të barazohet ose të rrjedhë nga maksima *fiat justitia pereat mundus*.²⁹

Në sfondin e kësaj analogjie del se, mosveprimi i gjykatës për shkak të mungesave në nenin 450 të KPP-së të një norme për të rishikuar vendimet

datës 29.07.2008. Po ashtu, ai kërkoi njohjen e pafajësisë për veprën penale të vrasjes dhe ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së.

²⁸ Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë (GJK), Vendimi nr. 22, datë 09.03.2010, 9. I disponueshëm në <www.gjk.gov.al> (hera e fundit e aksesuar: 10 Dhjetor 2013).

²⁹ Supra (nr.25), fq.5-6.

përfundimtare pas konstatimit të shkeljeve të procesit të drejtë nga GJEDNJ shkel parimin e barazisë së individëve para ligjit dhe gjykatës. Individët nuk mund të kenë status të diskriminuar në procesin penal në krahasim me procesin civil. Kur në këtë të fundit lejohet rishikimi i vendimeve me efekt *res judicata*, ku shpesh në procese të tilla preken interesa të personave të tretë që nuk kanë patur mundësi mbrojtjeje, aq më tepër që në procesin penal duhet lejuar rishikimi i vendimeve gjyqësore përfundimtare pasi individët rrezikojnë vlera dhe interesa shumë më të rëndësishme.³⁰

Gjykata Kushtetuese edhe pse vendosi mospranimin e kërkesës së Arben Xheraj me arsyetimin se 'juridiksioni kushtetues nuk duhet të shprehet për shpalljen e pavlefshmërisë së vendimeve të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm', duhet nënvizuar fakti se vendimi, edhe pse mospranimi, evidenton qartazi mënyrën e duhur për rivënien në vend të së drejtës së shkelur të aplikantit, pikërisht rihapjen e çështjes për të konsideruar vendimin e GJEDNJ-së. Gjykata, duke konstatuar se në legjislacionin e brendshëm procedural penal ekziston një vakum ligjor lidhur me mjetet procedurale për vënien në ekzekutim të vendimit të GJEDNJ-së, vë theksin në domosdoshmërinë e plotësimit nga Kuvendi të boshllëkut ligjor për këtë problem të rëndësishëm. Për më tepër, ajo vlerëson se edhe Gjykata e Lartë, si organi tek i cili është konstatuar shkelja nga GJEDNJ-ja, duhet të gjejë zgjidhjen për të vënë në vend të drejtën e shkelur të kërkesit duke aplikuar, nëse e çmon të nevojshme edhe analogjinë me zgjidhjen konkrete për këtë problem në Kodin e Procedurës Civile, pasi Gjykata e Lartë është organi kompetent për gjykimin e kësaj çështjeje.³¹

Kërkesa për rishikimin e vendimit u përball me një tjetër pengesë, pasi nuk u pranua nga Kolegji Penal me arsyetimin se ajo nuk përmban kushtet e parashikuara nga neni 450/a i KPP-së, i cili vendos si parakusht për rishikimin e një vendimi penal, ndryshimin ndërmjet fakteve mbi të cilat bazohet vendimi i ankimuar dhe fakteve të provuara në një tjetër vendim gjyqësor. Gjithashtu, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë konsideroi se fakti që GJEDNJ-ja ka konstatuar një shkelje të të drejtës për një proces të rregullt ligjor ndaj shtetasit të sipërpërmendur, përbën një indicie për nisjen e një gjykimi kushtetues dhe jo rishikues.³²

Situata e mësipërme është dukshëm rasti i përplasjes së mundshme midis rregullit të legjislacionit të brendshëm dhe parashikimit të Konventës, situatë në

³⁰ Po aty, 6.

³¹ Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, me vendimin nr.22, datë 9.03.2010 vendosi të shpallte moskompetencën dhe të drejtonte kërkesin në Gjykatën e Lartë, si institucioni i vetëm përgjegjës dhe kompetent për të përmbushur detyrimet që burojnë nga vendimi i GJEDNJ-së, konkretisht, rishikimin e vendimeve të mëparshme gjyqësore të formës së prerë në ngarkim të kërkesit dhe rikonfirmimin e vendimit të 14 dhjetorit 1998 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Durrësit më të cilin ishte vendosur pranimi i kërkesës së tij për pushimin e çështjes, me arsyetimin se nuk e kishte kryer veprën penale për të cilën akuzohej.

³² Vendimi nr. 22 (n 28).

të cilën gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të verifikojnë, veçanërisht, nëse është e mundur të interpretojnë normën e brendshme në përputhje me Konventën dhe, për këtë, mund të përdorin të gjitha teknikat interpretuese në dispozicion. Edhe pse “përplasja” midis juridiksioneve nuk u evitua, duhet pranuar se, pavarësisht zgjatjeve të procesit dhe rivendosjes me vonesë të drejtësisë, ajo rezultoi të ishte pozitive, pasi përfundimisht secili juridiksion ka konfirmuar diskrecionin në të tilla çështje.

Kërkesa për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë u pranua njëzëri nga Gjykata Kushtetuese³³ dhe çështja u kthye për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë, e cila vendosi pranimin e kërkesës, prishjen e vendimeve të të treja gjykatave të zakonshme dhe pushimin e gjykimit.³⁴

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese duhet konsideruar si guri i themelit për atë pjesë të jurisprudencës kushtetuese që trajton problematikën e çështjeve të rihapjes së procesit penal në zbatim të një vendimi të GJEDNJ-së në favor të aplikantit. Rëndësia e vendimit qendron në faktin se në mënyrë përfundimtare përcaktohet qartazi detyrimi se në kushtet kur nga GJEDNJ-ja janë konstatuar shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor ndaj kërkuesit, për shkak të kompetencës ekskluzive të GJEDNJ-së në këtë drejtim, ky fakt nuk mund të vihet në diskutim.

Qëllimi i procesit kushtetues në këtë rast është që të shfuqizojë ato vendime gjyqësore që kanë sjellë cenim të kësaj të drejte dhe t'i japë mundësi organeve gjyqësore, të veprojnë në përputhje me vendimet e GJEDNJ-së, me qëllim që të arrihet mbrojtja efektive e të drejtave të individit, në rastin konkret siguria dhe liria e tij vetjake. Po ashtu, me vlerë është edhe referimi në parimin e njohur se në lidhje me një të drejtë themelore, respektimi i detyrimeve ndërkombëtare nuk mundet asnjëherë të jetë shkak i një zvogëlimi të mbrojtjes së saj në krahasim me ato të parashikuara tashmë nga rendi i brendshëm, por mund dhe duhet, përkundrazi, të përbëjë instrument efikas të zgjerimit të vetë mbrojtjes. Nëse merret kjo si pikënisje në shqyrtimin e marrëdhënies së ndërmjetme normative midis niveleve të ndryshme të garancive, arrihet lehtësisht në përfundimin, se vlerësimi përfundimtar në lidhje me forcën efektive të mbrojtjes në raste të veçanta është fryt i një kombinimi virtuoz ndërmjet detyrimit që bie mbi ligjvënësin kombëtar për t'u përshtatur me parimet e vendosura nga GJEDNJ-ja, në interpretimin e saj gjyqësor, detyrim që në të njëjtën mënyrë bie mbi gjyqtarin e zakonshëm që t'i japë normave të brendshme një interpretim në përputhje me parimet e Konventës dhe detyrimin që në fund bie mbi Gjykatën Kushtetuese – në hipotezën e pamundësisë së një interpretimi pajtues – që të mos lejojë të vazhdojë të ketë vlerë ligjore në sistemin juridik një normë për të cilën është vërtetuar

³³ Kërkesa për pushimin e vendimit nr.417, datë 20.06.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë u rrëzua me shumicë votash, me arsyetimin e mungesës së juridiksionit.

³⁴ Gjykata e Lartë e Shqipërisë (GJL), Vendim nr.76, datë 07.03.2012. I disponueshëm në <<http://www.gjykataelarte.gov.al>> (hera e fundit e aksesuar: 10 Dhjetor 2013).

mungesa/pamjaftueshmëria e mbrojtjes në lidhje me një të drejtë themelore. Për më tepër, neni 53 i vetë KEDNJ-së përcakton se interpretimi i dispozitave të KEDNJ-së nuk mund të përmbajë nivele mbrojtjeje inferiore nga ato të siguruara nga burimet kombëtare.³⁵

Vlen të theksohet se rasti Xheraj nuk ishte rasti i parë në praktikën e Gjykatës së Lartë, pasi në disa vendime të tjera Kolegjet Penale kishin vendsour themelet e rihapjes së procedimeve penale. Gjykata e Lartë, në mungesë të referimit ligjor të shprehur në mënyrë formale, të drejtpërdrejtë, lehtësisht të lexueshëm, vlerëson se ‘vështrimi dhe trajtimi i këtyre çështjeve nga ana e drejtësisë nuk mund të jetë i ngrirë dhe i fosilizuar në të shkuarën, përkundrazi, është dhe duhet të jetë krijues e largpamës, bashkëkohor me qëllim të vetëm dhënien e drejtësisë dhe respektimin maksimal të të drejtave të njeriut’.³⁶ Për këto arsye, Gjykata e Lartë ka elaboruar edhe më tej problematikën e rishikimit të vendimeve të gjykatave të të tri shkallëve pas dhënies së vendimit përfundimtar të GJEDNJ-së, kur kjo e fundit ka konstatuar cenimin e nenit 6 të KEDNJ-së dhe rekomandon se ‘e vetmja mënyrë për t’i siguruar aplikantit restitucio in integrum është rihapja e procesit gjyqësor’. Gjykata e Lartë, duke e konsideruar procesin penal dhe pasojat që vijnë prej tij si “shumë delikate dhe të rëndësishme në raport me individin”, i referohet së pari teknikës së interpretimit me analogji, pasi një gjë e tillë është e rregulluar konkretisht në Kodin e Procedurës Civile, i cili e ka parashikuar shprehimisht rishikimin e vendimeve në nenin 494 të tij, nëse një gjë e tillë vjen si pasojë e vendimeve të GjEDNJ.³⁷ Po ashtu, duke u bazuar në parimet e përgjithshme, se gjykata nuk mund të refuzojë të japë drejtësi për shkak se ligji mungon ose është i paqartë, Gjykata e Lartë është e bindur se në mungesë të ligjit konkret të krijojë mjetin e duhur juridik për kërkesat e kësaj natyre.³⁸

Gjykata e Lartë, në zbatim të parimit se jo çdo shkelje e rregullave procedurale sjell si pasojë pavlefshmërinë e vendimit apo hetimit, vlerëson se jo çdo gjykim i

³⁵ GjK, Vendim nr.20, datë 01.06.2011 (i cili i referohet edhe vendimit nr. 317, datë 30.11.2009 të Gjykatës Kushtetuese Italiane). I disponueshëm në <www.gjk.gov.al> (hera e fundit e aksesuar: 10 Dhjetor 2013).

³⁶ GjL, Vendimi nr. 46, datë 15.02.2012, 7. I disponueshëm në <http://www.gjykataelarte.gov.al> (hera e fundit e aksesuar: 10 Dhjetor 2013). Kërkuesi Gentian Berhani pretendoi para GJEDNJ-së mungesën e arsytimit të vendimeve të gjykatave të brendshme, kohëzgjatjen e procesit gjyqësor dhe mungesën e paanësisë nga ana e trupit gjykues të Gjykatës së Apelit. GJEDNJ-ja, me vendimin e datës 04.10.2010 çmon se procesi gjyqësor i gjykatave të brendshme nuk i përmbushi kërkesat e drejtësisë të kërkuara nga neni 6(1) i Konventës dhe, për rrjedhojë, ka pasur shkelje të kësaj dispozite.

³⁷ *Berhani kundër Shqipërisë*, nr. 847/05, GJEDNJ, 4 tetor 2010, para. 24. Ankuesi pretendoi mungesën e arsytimit të vendimeve gjyqësore, kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit gjyqësor dhe mungesën e paanshmërisë së Gjykatës së Apelit.

³⁸ Shih komunikimin e rishikuar nga Shqipëria rreth çështjes *Berhani kundër Shqipërisë*, DH-DD(2011)314rev, datë 07.06.2011. 8. I disponueshëm në <https://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=2208829&SecMode=1&DocId=1733722&Usage=2> (hera e fundit e aksesuar: 10 Dhjetor 2013).

çështjes në GJEDNJ passjell në mënyrë të pakushtëzuar rigjykimin e çështjes në gjykatat shqiptare, por vetëm në ato raste kur shkeljet e konstatuara dhe të pretenduara të jenë të asaj natyre të cilat çënojnë apo bëjnë të pavlefshëm, të pabesueshëm, vendimin e dhënë. Kolegji Penal e konsideron vendimin e GjEDNJ-së një vendim të ri, i cili përbën një provë apo një fakt të ri në ato raste kur shkeljet e konstatuara nga ajo gjykatë janë të tilla të cilat motivojnë gjykatën për të çuar drejt rishikimit vendimin objekt gjykimi. Në vetvete, një vendim gjyqësor në formën e tij përfundimtar merr karakteristikat pothuajse të një norme, e një norme e cila ka fuqi detyruese për t'u zbatuar. Kjo është një nga karakteristikat të cilat i japin gjyqësorit të ashtuquajturin "*bërje ligji*".³⁹

Vendimmarrja e Gjykatës së Lartë në çështjet e mësipërme ka krijuar një precedent shumë të rëndësishëm me vlerën e mjetit efektiv për rivendosjen e të drejtave të çënuara. Pavarësisht mungesës në sistemin ligjor shqiptar të një mjeti procedural që bën të mundur rihapjen e procesit penal tashmë praktika gjyqësore evidenton shembuj konkretë të mundësisë për rihapjen e procesit pas dhënies së vendimit të GJEDNJ-së që konstaton shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, çka nënkupton se aplikantë të tjerë që do të kenë një vendim të GJEDNJ-së në favor kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikim sipas parashikimit të nenit 450 të KPP-së për të rivendosur të drejtat e shkelura.

Të analizosh mundësitë që parashikon sistemi ligjor shqiptar për rihapjen e procesit gjyqësor si masë me karakter individuale për të siguruar *restitutio in integrum* të aplikantit, nuk mund të anashkalosh vendimmarrjen e GJEDNJ-së kundër Shqipërisë ku konstatohet shkelje e nenit 6 të KEDNJ-së dhe rekomandohet pikërisht një proces *de novo*. Në çështjet *Caka kundër Shqipërisë*⁴⁰ dhe *Berhani kundër Shqipërisë*⁴¹ GJEDNJ-ja konstatoi shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës përse i përket mungesës së drejtësisë në procesin gjyqësor. Të dy vendimet kanë formulë arsyetimi të njëjtë; GJEDNJ-ja shprehet se konstatimi se ka patur shkelje të nenit 6 § 1 nënkupton se procesi në gjykatat kombëtare nuk

³⁹ Shih vendimet e Gjykatës së Lartë nr.46, datë 15.02.2012; Vendimin nr.74, datë 07.03.2012 me kërkesë *Vladimir Laska, Artur Lika*, të cilët ju drejtuan GJEDNJ-së duke pretenduar se procedura e ndjekur nga gjykatat e brendshme përbënte një mohim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Refuzimi i gjykatave për të paraqitur fakte, mbi bazën e të cilave ata ishin dënuar (kapuçët), ishte në shkelje të dispozitave të brendshme të vendit. Ata, gjithashtu, kundërshtuan rregullsinë e procedurës së identifikimit që ishte përdorur nga autoritetet vendase. GJEDNJ-ja me vendimin e datës 30.10.2012 arrin në përfundimin që procedimet gjyqësore në fjalë nuk përmbushnin kushtet e një gjykimi të drejtë. Për rrjedhojë, ka pasur shkelje të nenit 6 para. 1 në çështjen aktuale; Vendimin nr.76, datë 07.03.2012 me kërkesë *Arben Xherraj*.

⁴⁰ *Caka kundër Shqipërisë*, nr. 44023/02, GJEDNJ, 8 Mars 2010. Ankuesi pretendonte shkelje të Nenit 3 të Konventës për mungesë të ndihmës mjekësore të domosdoshme dhe të mjaftueshme në kohën që ai ishte i arrestuar, duke patur parasysh dëmtimet serioze që ai kishte pësuar. Ai, gjithashtu, është ankuar sipas Nenit 5 para. 3 të Konventës, për kohëzgjatjen e periudhës së tij të paraburgimit. Sipas Nenit 6 para. 3 (c) dhe (d) të Konventës, ai është ankuar se i ishte mohuar e drejta e një procesi të rregullt gjyqësor.

⁴¹ *Berhani kundër Shqipërisë* (n 37).

ka plotësuar kërkesat e procesit të rregullt. Gjykata i referohet jurisprudencës së konsoliduar se në rast të konstatimeve të tilla, aplikanti duhet të vihet sa më shumë të jetë e mundur në pozitën që ai do të kishte qenë nëse kërkesat e nenit 6 të Konventës do të ishin marrë në konsideratë. Po ashtu, Gjykata rithekson se në ato raste kur ajo konstaton se një aplikant është dënuar në mungesë të garancive të procesit të rregullt, mënyra më e mirë e kompensimit për shkeljen e bërë, në parim, do të ishte një process gjyqësor *de novo* ose rihapja e procesit, brenda një afati të përshtatshëm dhe në përputhje me kërkesat e nenit 6 të Konventës.⁴²

Përsa i përket masave të marra në nivel kombëtar rezulton se raportimet periodike të Avokaturës së Shtetit në Sekretariatit e Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës përmbajnë argumenta të njëjta lidhur me mospërbushjen e masave individuale, duke arsyetuar se Pala Shqiptare nuk mund të ekzekutojë menjëherë masat individuale lidhur me çështjen, përse kohë legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjet procedural për rishikimin e vendimit të formës së prerë për rihapjen e procesit penal në përputhje me vendimin e GJEDNJ-së. Lidhur me zbatimin e masave të përgjithshme, Avokatura e Shtetit konfirmon se aplikantit Caka dhe Berhani u është paguar, respektivisht, shpërblimi i drejtë përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.813, datë 13.10.2010 dhe nr.964, date 24.11.2010.⁴³

Në çështjen *Laska dhe Lika kundër Shqipërisë*, GJEDNJ-ja konstatoi shkelje të nenit 6, paragrafi 1 lidhur me mënyrën arbitrare të marrjes dhe të vlerësimit të provës vendimtare të fajësisë së tyre – paraqitjes për njohje dhe dëshmime okulare. Gjykata shprehet për marrjen e masave për ndreqjen e shkeljeve dhe rivendosjen e së drejtës së aplikantëve, në zbatim të nenit 46 të Konventës. Në mënyrë specifike Gjykata shprehet se “në çështjen në fjalë, Gjykata gjeti se e drejta e aplikantëve për një proces të drejtë ishte shkelur seriozisht nga autoritetet vendase”⁴⁴ dhe se, për këtë arsye, ajo gjykon se:

[N]ë çështjen në fjalë, një rigjykim ose rihapje e çështjes, nëse do të kërkohej nga aplikanti, përfaqëson në parim një mënyrë të përshtatshme të korrigjimit të shkeljes. Kjo është në përputhje me udhëzimet e Komitetit të Ministrave, të cilat në Rekomandimin Nr. R(2000)2 u bënë thirrje Shteteve Palë të Konventës që të prezantojnë mekanizma për rishqyrtim të çështjes dhe rihapje të procedimeve në nivel kombëtar, duke konstatuar se masa të tilla përfaqësojnë ‘mjetin më të efektshëm, në mos të vetmin mjet, për të arritur *restitutio in integrum*’.⁴⁵

GJEDNJ-ja, shkon edhe më tej në formulën e saj të arsyetimit në krahasim me atë

⁴² Shih vendimet e GJEDNJ-së në çështjet *Xheraj kundër Shqipërisë*, nr. 37959/02, 29 Korrik 2008, para. 82; *Laska dhe Lika kundër Shqipërisë*, nr.12315/04 dhe 17605/04, 20 korrik 2010, paras 73-77.

⁴³ Komunikimi i rishikuar (n 38).

⁴⁴ *Laska dhe Lika kundër Shqipërisë* (n 42).

⁴⁵ Po aty, para. 75.

të përdorur në çështjet e trajtuara më sipër. Ajo vëren që:

Sistemi ligjor penal i Shtetit shqiptar nuk ofron mundësinë për rishqyrtim të çështjeve, përfshi rihapjen e procedimeve në vend, në rastet kur kjo Gjykatë gjen një shkelje serioze të së drejtës së një aplikanti për proces të rregullt ligjor. Nuk varet nga Gjykata që të tregojë se si duhet siguruar një mundësi e tillë dhe çfarë forme duhet të marrë ajo. Shteti përgjegjës mbetet i lirë, nën monitorimin e Komitetit të Ministrave, që të zgjedhë mjetet me anë të së cilave do të ushtrojë detyrimin e tij për ta vendosur aplikantin, sa më shumë që mundet, në pozicionin që do të kishte qenë nëse kërkesat e Konventës nuk do të ishin injoruar, me kusht që mjete të tilla të jenë të përputhshme me përfundimet e përcaktuara në gjykimin e Gjykatës dhe me të drejtat e mbrojtjes. Megjithatë, Gjykata vlerëson se i takon shtetit shqiptar të eliminojë çdo lloj pengese në sistemin ligjor vendas që mund të pengojë zgjidhjen e çështjes së aplikantit në mënyrën më të përshtatshme, ose të parashikojë një mjet të ri që do t'i mundësojë aplikantit riparimin e situatës.⁴⁶

Nën dritën e zhvillimeve jurisprudenciale lidhur me rihapjen e procesit gjyqësor penal dhe standardeve të përcaktuara prej saj, rezulton se në kuadrin e masave individuale, të dy aplikantët i janë drejtuar Gjykatës së Lartë, duke kërkuar, midis të tjerash, rishikimin e vendimeve të deklarimit fajtor dhe dënimit, kërkesë e cila është pranuar, duke prishur vendimet e Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit Shkodër, me tjetër trup gjykues.⁴⁷ Përsa i përket masave me karakter të përgjithshëm, vendimi i GJEDNJ-së është përkthyer dhe botuar në Fletoren Zyrtare si dhe u është shpërndarë gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Po ashtu, rezulton se aktorët e interesuar lidhur me çështjen në fjalë janë angazhuar në marrjen e masave si p.sh. Prokurori i Përgjithshëm ka hartuar Qarkoren 3942/3, datë 27.01.2011 për paraqitjen e disa udhëzimeve për prokurorët për të parandaluar shkelje procedurale të ngjashme me ato të konstatuara nga GJEDNJ-ja në procese të ardhshme; Avokatura e Përgjithshme e Shtetit, e cila ka marrë rolin e ndërmjetësit të këtij procesi të rëndësishëm; Shkolla e Magjistraturës po zhvillon trainime të gjyqtarëve dhe prokurorëve; ndërsa Ministria e Drejtësisë ka zhvilluar disa inspektive.⁴⁸

Në vështrim të zhvillimeve të mësipërme të jurisprudencës së GJEDNJ-së është

⁴⁶ Po aty, paras 76-77.

⁴⁷ Vendimi i pakicës konstaton se kërkesa për rishikim është pranuar pjesërisht, mbasi mbetet në fuqi një vendim fajësie, ai i gjykatës së shkallës së parë, edhe pse rishikimi i këtij vendimi është kërkuar në mënyrë të shprehur ky fakt, por edhe kur parregullsia bazë është krijuar në këtë shkallë gjykimi. Në ndryshim me rastet e tjera të gjykimin të zakonshëm (neni 441/1 të KPP), në këtë lloj gjykimi të veçantë, gjykata e apelit nuk mund të zgjidhë paligjshmërinë e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, ndaj ky ka qenë edhe shkaku që ligjvënësi e ka përcaktuar në mënyrë taksative (neni 453, pika 3 të KPP) se duhet të priset vendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe çështja të dërgohet për rigjykim në këtë shkallë gjykimi.

⁴⁸ Supra (n 42).

e dukshme se edhe pse në mungesë të mjetit procedural për rihapjen e procedimit në legjislacionin vendas, jurisprudenca kushtetuese apo edhe praktika e gjykatave të sistemit të zakonshëm kanë luajtur dhe vazhdojnë në luajnë një rol mjaft të rëndësishëm, atë të interpretimit (me raste edhe me analogji) të kuadrit ligjor ekzistues, me qëllim gjetjen e garancive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore edhe kur këto garanci nuk janë të artikuluar shprehimisht nga sistemet ligjore kombëtare. Njëtrajtshmëria e vendimmarrjes mbetet vendimtare në këtë drejtim.

5. Konkluzione

Kushtetuta, në sistemin e akteve normative, e rendit KEDNJ-në menjëherë pas aktit më të lartë themelor të vendit. Si një marrëveshje e ratifikuar dhe e botuar në Fletoren Zyrtare Konventa përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik shqiptar dhe zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke patur epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.⁴⁹

Kuptimi i këtyre parashikimeve kushtetuese është përcaktuar nga jurisprudenca kushtetuese shqiptare, e cila është shprehur se:

Me rastin e ratifikimit të KEDNJ-së, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, si përfaqësues i sovranitetit popullor, ka marrë përsipër detyrime të cilat janë të zbatueshme nga të gjitha organet shtetërore të Republikës së Shqipërisë, përfshirë gjykatat e të gjitha niveleve, pavarësisht llojit të tyre. Për sa më sipër, detyrimet që mbartin secili nga pushtetet për zbatimin e vendimeve përfundimtare të GJEDNJ-së janë të ndryshme. Nëse për ekzekutivin janë menjëherë të ravigjzueshme këto detyrime, si p.sh. në rastin e pagimit të dëmshpërblimeve të imponuara nga GJEDNJ-ja, për sa i përket dy pushteteve të tjera ka vend për interpretim. Posaçërisht për sa i përket vendimeve të GJEDNJ-së për procedime penale, për legjislativin lind nevoja që të marrë masa për të harmonizuar legjislacionin e brendshëm me dispozitat e KEDNJ-së⁵⁰. Nëse nuk ka harmonizim pra, nëse jemi në rastet e vakumit legjislativ, ose kur parashikimet ligjore bien në kundërshtim me dispozitat e Konventës, atëherë gjyqtarët e çdo niveli zbatojnë drejtpërsëdrejti vendimet e GJEDNJ-së në përputhje me nenin 122 të Kushtetutës dhe nenet 19 dhe 46 të KEDNJ-së. Neni 122 i Kushtetutës përcakton shprehimisht se dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare kane epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të”.⁵¹

Duhet pranuar se jurisprudenca e GJEDNJ-së luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e jurisprudencës kombëtare në përputhje me praktikat më të mira evropiane. Vendimmarrja e gjykatave kushtetuese apo e gjykatave të sistemit të zakonshëm, në mungesë të normave procedurale për rihapjen e procesit

⁴⁹ Neni 122, pika 1-2 të Kushtetutës së RSH.

⁵⁰ Supra (n 42).

⁵¹ Po aty.

gjyqësor penal, përbën tashmë mjetin më efektiv për rivendosjen e të drejtave të aplikantit që ka një vendim të GjEDNJ-së në favor të tij. Megjithatë, nisur nga fakti se Gjykata Kushtetuese nuk është ligjvënës pozitiv, pasi nuk krijon norma të reja procedurale dhe, për rrjedhojë, nuk mund të përcaktojë as afatet konkrete dhe as procedurat që duhet të zbatohen gjatë rihapjes së proceseve penale, atëherë shteti shqiptar, në referim të nenit 46 të KEDNJ-së, duke qenë se është i lirë të zgjedhë mjetet për të vepruar në përputhje me vendimet e GjEDNJ-së dhe për të ofruar *restitutio in integrum*, duhet të marrë sa më shpejt masat për një reformë legislative gjithëpërfshirëse, veçanërisht për plotësimin e Kodit të Procedurës Penale me norma të reja, ose plotësimin e atyre ekzistuese, ku të parashikohet rishqyrtimi ose rihapja e procesit gjyqësor në zbatim të një vendimi të GjEDNJ-së që konstaton shkelje të drejtave të aplikantit, pasi vetëm në këtë mënyrë shtetasve do t'u garantohen të drejtat e parashikuara nga Kushtetuta dhe KEDNJ-ja.⁵²

Jurisprudenca e GjEDNJ-së i ka kushtuar rëndësi të vazhdueshme parimit të njohur të së drejtës ndërkombëtare *restitutio in integrum* duke vlerësuar se një vendim i Gjykatës, i cili konstaton shkelje, vendos për Shtetin Përgjegjës detyrimin ligjor për t'i dhënë fund shkeljes dhe për të riparuar pasojat në mënyrë të tillë që të vendoset sa më shumë të jetë e mundur situata ekzistuese përpara shkeljes. Në këtë kuptim, nevoja për të përmirësuar mundësitë që parashikojnë sistemet ligjore kombëtare bëhet gjithmonë dhe më e dukshme. Ndonëse vihet re një reagim nga ana e autoriteteve kombëtare në këtë drejtim, konstatohet se mungon uniformiteti në përcaktimin ligjor të mënyrave për rihapjen e procedimeve. Kjo reflektohet edhe në faktin se një numër i madh shtetesh kanë miratuar ligje të veçanta që sigurojnë mundësinë për rishqyrtimin ose rihapjen e proceseve,⁵³ kurse në disa shtete të tjera kjo mundësi është zhvilluar përmes interpretimit të gjykatave dhe autoriteteve kombëtare bazuar në legjislacionin ekzistues.⁵⁴Reformat në sistemet e drejtësisë kombëtare përbëjnë një tjetër mundësi për përmirësimin e kuadrit ligjor procedural.⁵⁵

⁵² Shembuj të proceseve të tilla amenduese dhe reformuese mund të gjejmë në disa shtete anëtare të Këshillit të Evropës, p.sh. Bosnjë-Hercegovina ka parashikuar në Kodin e Procedurës Penale norma të veçanta për rihapjen e procesit penal, konkretisht nenet 24, 327, germa "f", e vijues të KPP-së.

⁵³ Parlamenti Grek, në zbatim të vendimit të GjEDNJ-së në çështjen *Serif kundër Greqisë*, 14 dhjetor 1999, ndryshoi nenin 525(5) të Kodit të Procedurës Penale me Aktin Nr. 2865/19.12.2000 (neni 11) duke lejuar rihapjen e procesit në nivel kombëtar pas konstatimit të shkeljes me vendim të GjEDNJ-së. Edhe Parlamenti turk miratoi ligjin nr. 4793, pas dhënies së vendimit të GjEDNJ-së në çështjet *Küçük Yalçın kundër Turqisë* 05 Mars 2003 dhe *Özel kundër Turqisë*, 07 shkurt 2003, ku konstatohet shkelja e lirisë së shprehjes, që lejonte rihapjen e proceseve në nivel kombëtar për të gjitha vendimet e GjEDNJ-së të cilat kishin marrë formë të prerë përpara hyrjes në fuqi të ligjit. Duke qenë se ligji hyri në fuqi në 04/02/2003, rihapja e procesit nuk ishte e mundur për çështjet në fjalë.

⁵⁴ Supra (n 35).

⁵⁵ Shembuj te reformave ligjore për plotësimin e Kodit të Procedurës Penale gjejmë në disa vende anëtare të KE-së. Konkretisht, Komiteti i Ministrave raporton se në kuadrin e masave të përgjithshme që Shteti i Armenisë ka marrë për vënien në zbatim të masave individuale,

Në përfundim të kësaj analize konstatohet se, Kuvendi, si ligjvënës pozitiv, ende nuk e ka përmbushur misionin e besuar nga hartuesit e Kushtetutës për hartimin ose plotësimin e kuadrit ligjor me qëllim garantimin e të drejtave të njeriut. Për rrjedhojë, ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale mbeten sfida e radhës për Kuvendin e Shqipërisë, prandaj iniciativa ligjvënëse në këtë drejtim duhet të jetë prioritet, përndryshe çdo vonesë do të çonte në drejtësi të mohuar.

duhen përmendur ndryshimet në KPP dhe parashikimin në nenin 426 të rregullave procedurale për rihapjen e procesit penal, të subjekteve të cilët kanë të drejtë të paraqesin ankim për rishikimin e një vendimi gjyqësor në kushtet e rrethanave të zbuluara rishtaz; të afatit (3-mujor nga njoftimi i vendimit); të juridiksionin kompetent të shqyrtimit të çështjes në varësi të vendimit që ankimohet; të drejtën e ankimit kundër vendimit që refuzon rihapjen e procedimit. Shih për më tepër <<https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1799109&Site=DG4>> (hera e fundit e aksesuar: 10 Dhjetor 2013).